



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor  
Ministarstvo Sredine i Prostornog Planiranja  
Ministry of Environment and Spatial Planning

Shembulli – Studimi- Parku me erë»Kitka” Gjilan

## Përshkrimi i Projektit


- Në Parkun e Energjisë me erë „Kitka 32.5 MW” janë planifikuar të ndërtohen 13 copë turbina të tipit VENSYS 112 me kapacitet 2.5MW ne distancë mbi 300m - 350m varësisht prej pozitës së terrenit .
- Parametrat teknik të pajimeve dhe parametrat tjerë për ndërtimin e turbinave me erë ne lokacionin e Kamenicës janë:

- Q0 7.61m/s
- Qlog 11 m/s
- Qmax.extrem 22m/s
- Lartësia e shtyllave = 93.5-140m
- Numri i lopatave =3
- Perimetri i rrotullimit të lopatave =108.9m
- Numri i rrotullimeve =9-19 rr/min
- Fuqia instaluese për njësi =2.5MW
- Gjithesëjt fuqia instaluese = 13x 2.5MW =32.5MW

### Vend ndodhja e Parkut të Energjisë me erë

- Parku i Energjisë me erë „Kitka 32.5 MW” planifikohet të ndërtohet në lokacionet e fshatrave Poliçkë, Hogoshtë dhe Velegllavë e Epërme të komunës së Kamenicës.
- Komuna e Kamenicës shtrihet në lindje të Kosovës, gjegjësisht në pjesën lindore të fushëgropës të lumit Anamorava. Komuna e Kamenicës kufizohet me komunën e Gjilanit, Prishtinës, Artanës, Ranillugut, si dhe me komunat e Serbisë (Bujanovcit, Medvegjes dhe Vrajës). Territori i Komunës së Kamenicës është kodrinoro-malorë (70%) dhe rrafshinor (30%), me disa lugina rreth lumenjve të Krivarekës, Desivojcës dhe Hogoshtit. Toka është kryesisht pjellore, e pasur edhe me kullosa, e përshtatshme për zhvillim të pemëtarisë, perimtarisë, lavërtarisë dhe blegtorisë. Do të ndërtohen gjithsejtë 13 turbina me erë të identifikuar me numra prej Turbina nr. 1 – Turbina nr. 13: dhe do të ndërtohet nënstacioni.





- Objektet e banimit më të afërta nga turbinat me erë për prodhimin energjisë elektrike do të jen te larguara ne distancë mbi 500m.
- Shkolla gjendet ne largësi nga nga turbinat me erë për prodhimin energjisë elektrike ne distancë mbi 700m.
- Në këte lokacion gjendet e ndërtuar një antenë e valës për transmetimin e valve gjer te aparatet radiotelevizive dhe aparatet telefonike.
- **Flora dhe Fauna**-Lokacioni ku do të ndërtohen turbinat me erë është pak i pyllëzuar, i mbuluar me bar të egër, manaferra dhe me kaçuba të rralla, kurse ne largësi të afërt i rrethuar me pyje, si që janë bungu ,qarri ,ahu etj. me rritje të ulëta dhe mesatare.
- Në rrethinë të zonës ku realizohet projekti ekziston bimësi që karakterizohet kryesisht nga bimët e ulëta barishtore posaçërisht bar të egër , kultura periodike bujqësore si dhe të gjitha pemët frutore.
- Në bazë të dhënave nga banorët përpos shpezëve dhe kafshëve shtëpiake ne këte lokacion ekzistojnë dhelpira, ujku, lepuri , bretkosa, nga grupi i zogjve janë vërejtur; harabeli, sorrat , shqiponjat, qafka, pëllumbi, dallëndyshja etj .



- **Gjendja Hidrologjike** - Ne afërsi të lokacionit nuk ekzistojnë lumenj apo ujera në formë të liqejeve natyral apo artificial, por ujërat sipërfaqësore gjatë të reshurave atmosferike grumbullohen për mes përronjëve dhe pastaj për shkak të konfiguracionit derdhen në lumin e Desivojcës dhe të Lisockës .
- **Të dhënat e erës në lokacionin e Kitkës** - ka orografi të mire për shfrytëzimin e energjisë së ri përsëritshme të erës ku shpejtësia e erës në Kitkë në lartësinë 975-1187 metra mbi nivel të detit arrin shpejtësinë mesatare 7.61 m/s minimale 1.5 m/s dhe ajo maksimale 22 m/s.
- **Efektet vizuale ( peizazhi)** - Pamja e këtij regjioni është mjaft karakteristike, me pamje kodrinoro-malore, pjerrtësi të ndryshme , peizazhi është i bukur dhe tërheqës. Ajo që dallon peizazhin e këtij lokacioni është se nuk janë bërë ndryshime si pasojë e veprimtarisë së njeriut.
- **Trashëgimia Arkeologjike dhe Kulturore** - Ndonëse nuk ka të dhëna për ekzistimin e objekteve arkeologjike në vendet që do të gërmohet gjatë ndërtimit të parkut të energjisë me erë, nëse do të hasen objekte të tilla gjatë ndërtimit, atëherë punimet do të ndalohen dhe do të pritet ekspertiza e specializuar për të vlerësuar ecurinë e mëtejshme të projektit.



***Ju faleminderit për vëmendjen tuaj!***

***Shukri Shabani-MMPH***